

URDHËR
NR. 435, datë 17.10.2018

**PËR TËRHEQJEN E NJOHJES SË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË
PESHKIMIT (OMP, LIQENI I FIERZËS, KUKËS)**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 62, të kreut VII, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme të Peshkatarëve të Liqenit të Fierzës, në zbatim të programit të punës të DSHPA-së, të datës 24.9.2018 dhe me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Tërheqjen e njohjes së Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP, Liqeni i Fierzës, Kukës), bërë me urdhër të ministrit nr. 350, datë 5.9.2008, “Për miratimin e statusit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP, Liqeni i Fierzës, Kukës), Fletorja Zyrtare nr. 148, viti 2008.
2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në MBZHR, për zbatimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Niko Peleshi